



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 56291 Prot.
13

Pogradec, më 20.12. 2022

VENDIM
NR. 141, DATË 19.12. 2022
PËR

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.107 ,DATË
02.12.2021 PËR "MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË
BASHKINË POGRADEC PËR VITIN 2022" , I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të ligjit nr.139,datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore",i ndryshuar,ligjit nr.10926,datë 08.07.2011,"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore",i ndryshuar, ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec nr.107, datë 02.12.2021, "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec për vitin 2022", i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet e shkronjave a,b,c të pikës II.1.2 "Tarifa e pastrimit për bizneset" të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.107 ,datë 02.12.2021 për "Miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec për vitin 2022" i ndryshuar si vijon:

II.1.2 Tarifa e pastrimit për Bizneset

Tarifa e pastrimit për biznesin përcaktohet sipas kategorive të mëposhtme:

A. Tarifë pastrimi për biznesin me xhiro nga 0-3 milion lekë :



Kategorite e Biznesit	Njesia	Zona A	Zona B	Udenisht
Stomatologe(dentist) qe kane kontrate me subjekte te licensuara per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme(spitalore)	Leke/vit	6000	6000	6000

2. Të miratojë pikën II.2 Tarifa e gjelbërimit, ” të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.107 ,datë 02.12.2021 për "Miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec për vitin 2022" i ndryshuar,për këtë kategori biznesi.

Kjo Tarifë llogaritet në nivelin 50 % (për qind) të Tarifës së Pastrimit.

3.Bizneset qe nuk kane kontrate me kompanine e mbetjeve spitalore perjashtohen nga ky vendim.

4.Ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife.

5.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT

Sotiraq MANGËRI

